

Tiranë, më 7 korrik 2026

Drejtuar: Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI)
LËNDA: Komente dhe rekomandime në kuadër të konsultimit publik për
"Dokumentin e Politikave për Zhvillimin e NVM-ve 2026–2030"
(DPNVM)

I Nderuar Zëvendësministër Kajo,

ICC Albania mirëpret nismën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për hartimin e Draft-Dokumentit të Politikave për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme 2026–2030 (DPNVM) dhe mundësinë për të kontribuar në kuadër të procesit të konsultimit publik.

Drafti përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të politikave për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe tregon një nivel të mirë përafrimi me prioritetet e Bashkimit Evropian, përfshirë parimet e "Small Business Act", procesin e integritetit evropian, instrumentet financiare të BE-së dhe objektivat e transformimit digjital dhe tranzicionit të gjelbër.

Në të njëjtën kohë, analiza e draftit evidenton disa boshllëqe që lidhen me operacionalizimin e objektivave strategjike, realizueshmërinë financiare, mekanizmat institucionalë të zbatimit, monitorimin e rezultateve dhe koherencën ndërmjet analizës diagnostikuese dhe Planit të Veprimit.

Komentet e mëposhtme synojnë të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë, koherencës, realizueshmërisë dhe efektivitetit të dokumentit përfundimtar. Ato janë strukturuar sipas modelit "Konstatim – Vlerësim – Rekomandim", me qëllim lehtësimin e shqyrtimit të tyre gjatë procesit të rishikimit të draftit.

1. Vlerësim i përgjithshëm

Konstatim: Projekt-Dokumenti i Politikave për Zhvillimin e NVM-ve 2026–2030 paraqet një bazë të konsoliduar strategjike dhe tregon një nivel të mirë përafrimi me *acquis* të Bashkimit Evropian, dokumentet strategjike kombëtare dhe prioritetet e procesit të integritetit evropian. Dokumenti identifikon në mënyrë të drejtë sfidat kryesore të

sektorit të NVM-ve, përfshirë produktivitetin e ulët, fragmentimin institucional, aksesin në financa, transformimin digjital dhe tranzicionin e gjelbër.

Vlerësim: Megjithëse analiza diagnostikuese është përgjithësisht e plotë dhe e argumentuar, në disa raste ekziston një mospërputhje ndërmjet nivelit strategjik dhe komponentit operacional të dokumentit. Disa objektiva dhe angazhime të rëndësishme nuk janë përkthyer në masa konkrete, institucione përgjegjëse, tregues monitorimi apo burime të qarta financimi. Gjithashtu, dokumenti mund të përfitojë nga forcimi i mekanizmave të koordinimit ndërinstitutional, monitorimit të rezultateve dhe përmirësimi i cilësisë editoriale.

Rekomandim: Rekomandohet që versioni përfundimtar i DPNVM-së të forcojë lidhjen ndërmjet analizës strategjike dhe Planit të Veprimit, duke siguruar që çdo prioritet i identifikuar të shoqërohet me masa konkrete, burime të qarta financimi, institucione përgjegjëse dhe tregues të matshëm të performancës.

2. Mungesa e operacionalizimit të ristrukturimit parandalues dhe "shansit të dytë"

Konstatim: Drafti identifikon përafrimin me Direktivën (BE) 2019/1023 mbi ristrukturimin parandalues, falimentimin dhe "shansin e dytë" si një nga elementët kryesorë të procesit të përafrimit me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe e paraqet këtë komponent si pjesë të reformave që synojnë rritjen e qëndrueshmërisë së NVM-ve.

Megjithatë, në pjesën operacionale të dokumentit ky prioritet nuk reflektohet në mënyrë të plotë. Qëllimi Strategjik 3 fokusohet kryesisht në aksesin në financa dhe edukimin financiar, ndërsa mungon një objektiv specifik, masa konkrete, institucione përgjegjëse, afate zbatimi dhe tregues monitorimi për zbatimin e kuadrit të ristrukturimit parandalues. (Përmbledhja ekzekutive, Seksioni 1.4.3, QS3)

Vlerësim: Ekziston një mospërputhje ndërmjet nivelit strategjik dhe atij operacional të dokumentit. Një prioritet që identifikohet si pjesë e procesit të përafrimit me *acquis* nuk pasqyrohet në Planin e Veprimit me instrumente konkrete zbatimi.

Kjo dobëson koherencën e dokumentit, vështirëson monitorimin e progresit dhe krijon paqartësi mbi mënyrën se si do të realizohen angazhimet që lidhen me transpozimin dhe zbatimin efektiv të Direktivës (BE) 2019/1023. Për më tepër, mungesa e këtij komponenti kufizon potencialin e politikës për të promovuar kulturën e ristrukturimit të hershëm të ndërmarrjeve dhe mekanizmat e "shansit të dytë", të cilët konsiderohen elementë të rëndësishëm të klimës moderne të biznesit në Bashkimin Evropian.

Rekomandim: Rekomandohet përfshirja e një objektivi ose nënobjektivi specifik për ristrukturimin parandalues dhe "shansin e dytë", në përputhje me Direktivën (BE) 2019/1023, të shoqëruar me:

- masa konkrete zbatimi;
- institucione përgjegjëse;
- afate të qarta;
- burime financimi;

- dhe tregues monitorimi.

Nëse kjo fushë synohet të trajtohet nëpërmjet një dokumenti tjetër politikash ose reforme ligjore, kjo duhet të sqarohet shprehimisht në DPNVM për të shmangur paqartësitë mbi mënyrën e realizimit të këtij prioriteti.

3. Mospërputhja ndërmjet objektivave të deklaruar dhe strukturës së dokumentit

Konstatim: Në Përmbledhjen Ekzekutive deklarohet se dokumenti përmban 3 qëllime strategjike, 11 objektiva specifike dhe 25 masa. Megjithatë, nga analiza e strukturës së dokumentit rezultojnë vetëm 10 objektiva specifike.

Kjo mospërputhje lidhet edhe me mungesën e operacionalizimit të komponentit për ristrukturimin parandalues. (Seksioni 3)

Vlerësim: Përputhja ndërmjet pjesës përmbledhëse dhe strukturës operationale përbën një kërkesë bazë të cilësisë së dokumenteve strategjike. Mospërputhje të tilla krijojnë paqartësi për institucionet zbatuese dhe vështirësojnë monitorimin e progresit gjatë zbatimit të politikës.

Rekomandim: Rekomandohet verifikimi i plotë i strukturës së dokumentit dhe harmonizimi i numrit të objektivave, masave dhe treguesve në të gjitha seksionet e DPNVM-së. Nëse synohet ruajtja e numrit të deklaruar të objektivave, dokumenti duhet të plotësohet me objektivin përkatës.

4. Përafrimi me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe nevoja për operacionalizim

Konstatim: Drafti tregon për një nivel të mirë përafrimi me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe referon instrumente të rëndësishme si Small Business Act, Direktivën 2011/7/BE, Direktivën (BE) 2019/1023, mekanizmin CBAM dhe programet Horizon Europe, Digital Europe Programme dhe European Digital Innovation Hubs.

Megjithatë, në shumicën e rasteve ky përafrim mbetet në nivel deklarativ. Dokumenti nuk përcakton tregues bazë (baseline), objektiva të matshëm apo mekanizma monitorimi që të mundësojnë vlerësimin e progresit të NVM-ve shqiptare në raport me këto instrumente. (Seksioni 1.4.3; seksionet mbi *acquis* dhe programet e Bashkimit Evropian)

Vlerësim: Përafrimi me *acquis* nuk duhet të kufizohet vetëm në transpozimin formal të legjislacionit, por duhet të reflektohet edhe në rezultate konkrete dhe të matshme.

Mungesa e treguesve të performancës dhe e një analize të boshllëqeve/hendekut (gap analysis) kufizon mundësinë për të vlerësuar progresin real të politikës dhe ndikimin e saj në procesin e integritetit ekonomik dhe institucional të vendit.

Rekomandim:

- Të përcaktohen treguesit bazë (baseline) dhe objektivat sasiorë për secilin instrument të rëndësishëm të Bashkimit Evropian;

- Të përfshihen tregues që matin pjesëmarrjen e NVM-ve shqiptare në programet Horizon Europe, Digital Europe Programme dhe European Digital Innovation Hubs;
- Të hartohet një analizë e hendekut (gap analysis) për transpozimin dhe zbatimin e *acquis*; dhe
- Të lidhet çdo angazhim evropian me masa konkrete në Planin e Veprimit.

5. Nevoja për operacionalizimin e Direktivës 2011/7/BE mbi vonesat në pagesa

Konstatim: Drafti referon Direktivën 2011/7/BE si pjesë të kuadrit të *acquis* të Bashkimit Evropian me të cilin synohet përafrimi. Megjithatë, Plani i Veprimit nuk parashikon masa të dedikuara për adresimin e vonesave në pagesa, veçanërisht në marrëdhëniet ndërmjet administratës publike dhe ndërmarrjeve.

Po ashtu, mungojnë tregues që mundësojnë monitorimin e përmirësimit të disiplinës së pagesave, pavarësisht se likuiditeti përbën një nga sfidat kryesore të NVM-ve. (Seksioni 1.4.3; Qëllimet Strategjike; Plani i Veprimit)

Vlerësim: Pagesat e vonuara ndikojnë drejtpërdrejt në kapitalin qarkullues, aftësinë investuese dhe qëndrueshmërinë financiare të NVM-ve. Për këtë arsye, adresimi i tyre përbën jo vetëm detyrim në kuadër të përafrimit me *acquis*, por edhe një instrument të rëndësishëm për përmirësimin e klimës së biznesit.

Në mungesë të masave konkrete dhe treguesve të matshëm, referenca ndaj Direktivës 2011/7/BE mbetet kryesisht deklarative.

Rekomandim: Rekomandohet përfshirja e një mase të dedikuar për zbatimin gradual të Direktivës 2011/7/BE, e shoqëruar me tregues të tillë si p.sh. koha mesatare e pagesës nga institucionet publike; përqindja e faturave të paguara brenda afatit ligjor; ulja progresive e vonesave në pagesa; raportimi periodik mbi performancën e institucioneve publike në këtë drejtim.

6. Transparenca e metodologjisë së kostimit dhe realizueshmëria financiare

Konstatim: Në Planin e Veprimit një numër i konsiderueshëm masash paraqiten me vlera buxhetore të njëjta ose shumë të ngjashme, pavarësisht ndryshimeve të konsiderueshme në kompleksitet, shtrirje dhe natyrë.

Gjithashtu, dokumenti nuk shpjegon metodologjinë e përdorur për kostimin e masave, nuk specifikon njësinë monetare dhe nuk bën dallimin ndërmjet financimit nga buxheti i shtetit, fondet e Bashkimit Evropian dhe burimeve të tjera të financimit. (Matrica e Planit të Veprimit)

Vlerësim: Mungesa e transparencës mbi metodologjinë e kostimit e bën të vështirë vlerësimin e realizueshmërisë financiare të politikës. Një dokument strategjik duhet të tregojë qartë se si janë vlerësuar kostot, cilat janë supozimet mbi të cilat mbështetet planifikimi financiar dhe si do të sigurohen burimet për zbatimin e secilës masë.

Në formën aktuale, kostimi nuk pasqyron diferencimin real të ndërhyrjeve dhe krijon pasiguri mbi realizueshmërinë e Planit të Veprimit.

Rekomandim:

- Të publikohet metodologjia e kostimit;
- Të përcaktohet kostoja specifike për secilën masë;
- Të identifikohen burimet e financimit (buxheti i shtetit, IPA III, ĒBIF, Instrumenti i Reformës dhe Rritjes, donatorët dhe burime të tjera);
- Të verifikohet koherenca ndërmjet kostove të planifikuara dhe rezultateve të pritshme;
- Të përfshihet një plani financiar shumëvjeçar që mbështet zbatimin e dokumentit.

7. Kapacitetet institucionale dhe koordinimi ndërinstitucional

Konstatim: Drafti identifikon fragmentimin institucional si një nga sfidat kryesore të politikës për zhvillimin e NVM-ve.

Megjithatë, dokumenti nuk përcakton në mënyrë të detajuar mekanizmat për koordinimin ndërmjet institucioneve përgjegjëse për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e masave. Në disa raste nuk është e qartë ndarja funksionale e përgjegjësisë dhe mënyra e koordinimit ndërmjet institucioneve. (Seksionet që trajtojnë qeverisjen e politikës dhe Planin e Veprimit.)

Vlerësim: Përvoja e strategjive të mëparshme tregon se mungesa e koordinimit ndërinstitucional përbën një nga faktorët kryesorë që kufizon efektivitetin e politikave publike. Në mungesë të një mekanizmi formal koordinues ekziston rreziku i mbivendosjes së kompetencave, fragmentimit të burimeve dhe raportimit jo të unifikuar.

Rekomandim: Rekomandohet krijimi i një mekanizmi formal koordinimi ndërinstitucional, me pjesëmarrjen e institucioneve përgjegjëse për zhvillimin e NVM-ve dhe transformimin ekonomik.

Ky mekanizëm duhet të përcaktojë:

- përgjegjësitë e secilit institucion;
- procedurat e koordinimit;
- raportimin periodik;
- mekanizmat për zgjidhjen e çështjeve ndërinstitucionale;
- monitorimin e përbashkët të zbatimit të Planit të Veprimit.

8. Forcimi i sistemit të monitorimit dhe orientimi drejt rezultateve

Konstatim: Dokumenti përfshin një sistem treguesish monitorimi, por shumica e tyre matin kryesisht aktivitete administrative ose produkte (outputs), ndërsa janë të kufizuara matjet mbi rezultatet reale (outcomes) dhe ndikimin e politikës.

Po ashtu, mungojnë tregues bazë (baseline) për një pjesë të konsiderueshme të objektivave, si dhe objektiva të matshëm afatmesëm. (Seksioni "Monitorimi dhe Vlerësimi"; Matrica e Planit të Veprimit)

Vlerësim: Një sistem monitorimi i orientuar kryesisht drejt output-eve nuk lejon vlerësimin e efektivitetit real të politikës. Dokumenti duhet të mundësojë matjen e ndryshimeve që politika prodhon në funksionimin e NVM-ve, konkurrueshmërinë, produktivitetin, aksesin në financa, transformimin digjital dhe cilësinë e shërbimeve publike.

Gjithashtu, monitorimi duhet të krijojë bazën për rishikimin periodik të politikës dhe përmirësimin e saj gjatë zbatimit.

Rekomandim: Rekomandohet zgjerimi i sistemit të monitorimit përmes:

- treguesve bazuar në rezultate;
- përcaktimit të treguesve bazë për secilin objektiv strategjik;
- matjes së kënaqësisë së NVM-ve me shërbimet publike;
- monitorimit të kohës reale të ofrimit të shërbimeve administrative;
- matjes së ndikimit të instrumenteve mbështetëse mbi produktivitetin, investimet, eksportet dhe rritjen e ndërmarrjeve;
- publikimit periodik të rezultateve të monitorimit në funksion të transparencës dhe llogaridhënies.

9. Forcimi i dialogut publik–privat dhe rolit të organizatave të biznesit në zbatimin e politikës

Konstatim: Drafti njeh rëndësinë e dialogut publik–privat dhe identifikon Këshillin Konsultativ të NVM-ve si mekanizmin kryesor të konsultimit. Gjithashtu, parashikon instrumente të dobishme si SME Test, konsultimet sektoriale dhe skemat mbështetëse për inovacionin.

Megjithatë, roli i organizatave të biznesit mbetet kryesisht konsultativ. Dokumenti nuk parashikon mekanizma që mundësojnë përfshirjen e tyre në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave. Gjithashtu, mungojnë tregues që matin cilësinë dhe efektivitetin e dialogut publik–privat. (Seksioni "Monitorimi dhe Vlerësimi"; dispozitat mbi Këshillin Konsultativ të NVM-ve; Plani i Veprimit.)

Vlerësim: Përvoja ndërkombëtare tregon se organizatat përfaqësuese të biznesit mund të kontribuojnë jo vetëm në fazën e konsultimit, por edhe në zbatimin e politikave publike, përmes ofrimit të shërbimeve për biznesin, ngritjes së kapaciteteve, monitorimit të rezultateve dhe identifikimit të pengesave në zbatim.

Në mungesë të indikatorëve cilësorë, nuk është e mundur të vlerësohet nëse mekanizmat ekzistues të konsultimit adresojnë në mënyrë efektive nevojat e komunitetit të biznesit.

Rekomandim:

- Të forcohet roli i organizatave të biznesit si partnerë në zbatimin e masave specifike;
- Të institucionalizohen mekanizmat periodikë të konsultimit gjatë gjithë ciklit të zbatimit të politikës;
- Të përfshihen tregues që matin nivelin e kënaqësisë së NVM-ve me procesin e konsultimit dhe cilësinë e shërbimeve publike;
- Të publikohen periodikisht rezultatet e këtyre vlerësimeve si pjesë e raportimit të monitorimit.

10. Trajtimi i informalitetit si prioritet horizontal i politikës

Konstatim: Drafti identifikon drejt disa prej sfidave strukturore të ekonomisë shqiptare, si produktiviteti i ulët, dominimi i mikro-ndërmarrjeve dhe përqendrimi sektorial.

Megjithatë, informaliteti nuk trajtohet si një sfidë më vete dhe nuk shoqërohet me objektiva, masa apo tregues specifikë, ndonëse ai ndikon drejtpërdrejt në konkurrencën e ndershme, produktivitetin, të ardhurat fiskale dhe funksionimin e tregut. (Seksionet 2.1 dhe 2.2 – Situata aktuale dhe sfidat strukturore)

Vlerësim: Adresimi i informalitetit është kusht për përmirësimin e klimës së biznesit dhe rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë.

Në mungesë të një qasjeje të integruar për formalizimin progresiv të aktivitetit ekonomik, ekziston rreziku që një pjesë e konsiderueshme e ndërhyrjeve mbështetëse të mos prodhojnë rezultatet e synuara.

Rekomandim: Rekomandojmë të reflektohen si më poshtë:

- njohja e informalitetit si një prioritet horizontal i politikës;
- përfshirja e masave që nxisin formalizimin progresiv të aktivitetit ekonomik;
- koordinimi i këtyre masave me politikat fiskale, digjitalizimin e administratës dhe inspektimet e bazuara në analizën e riskut;
- përfshirja e treguesve që matin progresin e formalizimit.

11. Operacionalizimi i dimensionit territorial të politikës

Konstatim: Drafti evidenton përqendrimin e aktivitetit ekonomik dhe të instrumenteve mbështetëse në zonat urbane, veçanërisht në rajonin e Tiranës.

Megjithatë, kjo analizë nuk reflektohet në Planin e Veprimit. Masat e propozuara nuk përmbajnë objektiva rajonale, kriterë territoriale apo mekanizma që garantojnë një shpërndarje më të balancuar të mbështetjes publike. (Seksioni 2.1.4 – Dallimet rajonale dhe sektoriale; Seksioni 3)

Vlerësim: Ekziston një mospërputhje ndërmjet analizës diagnostikuese dhe ndërhyrjeve të propozuara.

Në mungesë të instrumenteve të diferencuara sipas karakteristikave rajonale, ekziston rreziku që pabarazitë territoriale të vazhdojnë ose të thellohen gjatë zbatimit të politikës.

Rekomandim: Rekomandohet

- përfshirja e kriterëve territoriale në instrumentet financiare dhe programet mbështetëse;
- përcaktimi i objektivave rajonalë;
- monitorimi i shpërndarjes gjeografike të fondeve dhe përfituesve;
- publikimi periodik i rezultateve sipas qarqeve ose rajoneve.

12. Plotësimi i hendeqeve horizontale të politikës

Konstatim: Analiza eidenton disa çështje që trajtohen pjesërisht ose nuk adresohen në mënyrë të mjaftueshme në draft.

Këto përfshijnë:

- segmentin e ndërmarrjeve me potencial rritjeje ("missing middle");
- integrimin e dimensionit gjinor në hartimin dhe monitorimin e politikave;
- analizën e riskut të zbatimit;
- mekanizmat për përballimin e rreziqeve (mitigation) që lidhen me kapacitetet institucionale, financimin dhe koordinimin.

Vlerësim: Mungesa e këtyre elementeve kufizon karakterin gjithëpërfshirës të dokumentit.

Politikat moderne për zhvillimin e NVM-ve mbështeten gjithnjë e më shumë në analiza të riskut, objektiva horizontale dhe instrumente të diferencuara sipas profileve të ndryshme të ndërmarrjeve. Përfshirja e tyre do të rriste qëndrueshmërinë dhe fleksibilitetin e politikës gjatë zbatimit.

Rekomandim: Rekomandohet

- përfshirja e një analize të riskut të zbatimit, me masa zbutëse për secilin risk kryesor;
- integrimi i dimensionit gjinor në objektivat, treguesit dhe monitorimin e politikës;
- përcaktimi i masave të dedikuara për segmentin "missing middle", me synim mbështetjen e ndërmarrjeve me potencial rritjeje;
- rishikimi periodik i këtyre elementeve gjatë zbatimit të dokumentit.

13. Cilësia editoriale, aksesueshmëria dhe transparenca e dokumentit

Konstatim: Gjatë shqyrtimit të draftit janë evidentuar disa pasaktësi redaksionale, gabime teknike dhe mungesë konsistence në numerim dhe formatim. Gjithashtu, dokumenti përdor në disa raste terminologji të specializuar dhe akronime pa shpjegime të mjaftueshme, gjë që mund të kufizojë kuptueshmërinë e tij për komunitetin e biznesit.

Po ashtu, dokumenti nuk parashikon një plan komunikimi apo një përmbledhje praktike të orientuar drejt NVM-ve.

Vlerësim: Megjithëse këto elemente nuk ndryshojnë përmbajtjen e politikës, ato ndikojnë në cilësinë formale, transparencën dhe aksesueshmërinë e dokumentit.

Një dokument strategjik duhet të jetë jo vetëm teknikisht korrekt, por edhe i kuptueshëm për subjektet që synon të mbështesë.

Rekomandohet:

- kryerja e një rishikimi të plotë gjuhësor, teknik dhe editorial përpara miratimit;
- unifikimi i terminologjisë, tabelave, numerimit dhe listës së shkurtimeve;
- hartimi i një përmbledhjeje praktike të dokumentit në gjuhë të thjeshtë për komunitetin e biznesit;
- përgatitja e një plani komunikimi për informimin e NVM-ve mbi instrumentet mbështetëse;
- parashikimi i një udhërrëfyesi orientues me etapa të zbatimit dhe raportimit periodik.

14. Rekomandime të përmbledhura sipas prioritetit

Rekoamndime kryesore

Këto janë rekomandime që ndikojnë drejtpërdrejt në koherencën, realizueshmërinë dhe zbatueshmërinë e DPNVM-së.

1. **Operacionalizimi i Direktivës (BE) 2019/1023**, përmes përfshirjes së një objektivit specifik, masave konkrete, institucioneve përgjegjëse, afateve dhe treguesve të monitorimit për ristrukturimin parandalues dhe "shansin e dytë".
2. **Përfshirja e një mase të dedikuar për zbatimin e Direktivës 2011/7/BE**, me tregues të matshëm për disiplinën e pagesave dhe reduktimin e vonesave në pagesat publike.
3. **Rishikimi i metodologjisë së kostimit dhe kornizës financiare**, duke përcaktuar kosto reale për secilën masë dhe burimet përkatëse të financimit.
4. **Forcimi i mekanizmave të koordinimit ndërinstitutional**, me ndarje të qartë të përgjegjësi, raportim periodik dhe mekanizma të përbashkët monitorimi.
5. **Përmirësimi i sistemit të monitorimit**, duke kaluar nga tregues të orientuar drejt aktiviteteve (outputs) në tregues të orientuar drejt rezultateve (outcomes), të mbështetur në tregues bazë dhe objektiva të matshëm.

Prioritete për forcimin e zbatimit

Këto rekomandime synojnë të rrisin efektivitetin, gjithëpërfshirjen dhe ndikimin e politikës.

6. **Forcimi i rolit të organizatave të biznesit**, duke i përfshirë jo vetëm në konsultim, por edhe në zbatimin dhe monitorimin e masave.
7. **Trajtimi i informalitetit si prioritet horizontal**, me masa të dedikuara për formalizimin progresiv të aktivitetit ekonomik.
8. **Përfshirja e dimensionit territorial**, përmes objektivave rajonalë dhe kriterëve për shpërndarjen e instrumenteve mbështetëse.
9. **Integrimi i analizës së riskut, dimensionit gjinor dhe segmentit "missing middle"**, si elementë horizontalë të politikës.
10. **Forcimi i komponentit të përafrimit me *acquis***, përmes treguesve të matshëm dhe një analize të boshllëqeve (gap analysis) për zbatimin e legjislationit dhe instrumenteve të Bashkimit Evropian.

Rekomandime plotësuese

Këto rekomandime nuk ndikojnë drejtpërdrejt në strukturën e politikës, por kontribuojnë në rritjen e transparencës, cilësisë dhe aksesueshmërisë së saj.

11. **Përmirësimi i cilësisë gjuhësore**, teknike dhe editoriale të dokumentit.
12. **Hartimi i një përmbledhjeje praktike dhe plani komunikimi**, të orientuar drejt komunitetit të biznesit.
13. **Përgatitja e një udhërrëfyese të zbatimit**, me etapa, piketa (milestones) dhe raportim periodik.
14. **Specifikimi më i qartë i përdorimit të instrumenteve financiare të Bashkimit Evropian** (p.sh. IPA III, ËBIF dhe Instrumenti për Reforma dhe Rritje), në mbështetje të zbatimit të masave.

ICC Albania mbetet e angazhuar për të kontribuar në mënyrë konstruktive gjatë fazave të mëtejshme të këtij procesi dhe mbetet në dispozicion për çdo sqarim teknik, diskutim apo bashkëpunim të nevojshëm për përmirësimin e dokumentit përfundimtar.

Me respekt,



Ardita Seknajt

Sekretar i Përgjithshëm